

HASAN BELLO

**POLITIKA E MBRETËRISË SHQIPTARE PËR PARANDALIMIN
E SHPËRNGULJES SË KOSOVARËVE DREJT TURQISË
DHE MOSRATIFIKIMIN E KONVENTËS
JUGOSLLAVO-TURKE TË VITIT 1938**

Që nga viti 1913, një pjesë e trojeve dhe popullsisë shqiptare kishte mbetur brenda kufijve të Serbisë dhe Malit të Zi. Autoritetet jugosllave vepruan sipas një programi “të studiuar”, të ndjekur sistematikisht për një kohë të gjatë, thelbi i të cilit ishte thyerja e homogjenitetit të kësaj popullsie kompakte dhe eliminimi i saj fizik.¹ Beogradi synonte të krijonte për shqiptarët kushte të padurueshme dhe t’u impononte atyre shpërnguljen.² Meqenëse zhvendosja në viset e tjera në brendësi të Jugosllavisë nuk kishte rezultuar një masë efikase, atëherë u ndoq një rrugë tjetër, shpërngulja e tyre drejt Turqisë. E gjendur përballë këtij fakti, qeveria shqiptare mbajti një qëndrim të vendosur. Interesi kombëtar e kërkonte që ata të mos emigronin në Turqi, por, as në brendësi të territoreve të Mbretërisë Shqiptare, për arsye se gjendja financiare e shtetit shqiptar, nuk e lejonte emigrimin e tyre në një masë kaq të madhe.³

¹ Hajredin Hoxha, “Politika e eliminimit total të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër”, *Përparimi*, Prishtinë, nr.5, 1970, f.430.

² Më gjerësisht mbi këtë politikë antishqiptare që u ndoq për kolonizimin e Kosovës sipas etapave dhe rajoneve *shih*: Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë-Instituti i Historisë, Tiranë: Iliria, 1992, f.99-128; *Po ai*, “Përpyqjet serbo-malazeze për kolonizimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në vitet 1913-1915”, *Studime Historike*, nr.4, Tiranë: 1983, f.127; *Po ai*, “Pikëpamjet e përfaqësuesve të borgjezisë serbe rreth reformës agrare kolonizuese në trevat shqiptare (1918-1941)”, *Studime Historike*, nr.3, Tiranë: 1989, f.65; Zamir Shtylla, “Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936-1941”, *Studime Historike*, nr.3, Tiranë: 1990, f.79.

³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V) 1928, Dosja (më tej: D) 155, fl.31. Raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Kryeministrinë lidhur me shpërnguljen e popullsisë shqiptare të Kosovës drejt Turqisë dhe Shqipërisë, 16.1.1929.*

Shumica e emigrantëve që shkonin në Turqi vendoseshin në hapësirat e zbrazëta të Anadollit. Sipas një raporti të kryekonsullatës shqiptare të Stambollit këta individë ishin viktime të injorancës, që nuk mund të kuptonin dot se nga cila anë rëndonte interesi i tyre kombëtar dhe se ku duhet të emigronin.⁴ Kjo popullsi e shpërngulur për shkaqe politike, në mënyrë iluzive mendonte se do të vendosej në qytetet e Turqisë. Këtë iluzion agjentura jugosllave kishte arritur t'ua nguliste në kokë me anë të propagandës.

Politika e Jugosllavisë synonte që me anë të dhunës të spastronte elementin shqiptar përgjatë kufirit dhe në vend të tij, të instalonte kolonë sllavë. Ndërsa qeveria turke kishte interes të mbushte zonat e zbrazura të Anadollit dhe të formonte një brez që do t'ia ngushtonte hapësirën popullsisë kurde dhe veprimeve të saj antiturke.⁵

Ambasadori italian në Beograd i raportonte Romës se autoritetet jugosllave mbanin një qëndrim kategorik, duke refuzuar dhënien e vizave për nënshtetasit kosovarë që dëshironin të vendoseshin në Shqipëri. E kundërta ndodhi me ata persona që kishin si destinacion Turqinë. Arsyeja e kësaj mase, sipas tij, duhej kërkuar në faktin se qeveria jugosllave i druhej krijimit të një bërthame irredentistësh kosovarë në Shqipëri.⁶ Përballë kësaj situate të vështirë autoritetet konsullore shqiptare bënë përpjekje që në portet e tranzitit nga ku kosovarët niseshin drejt Turqisë, t'i bindnin këta për t'u kthyer në atdhe, ku një bërthamë të emigruarish nga Kosova do të ishte kundërvepruesi më i mirë ndaj veprimtarisë propagandistike të qeverisë jugosllave dhe agjentëve të saj.

Në kuadër të politikës shkombëtarizuese, qeveria jugosllave, vepronte si kundër elementit shqiptar ashtu dhe atij maqedon edhe nëpërmjet bankave. Kështu, Banka Kombëtare Jugosllave i kishte dhënë urdhër të gjitha bankave të Serbisë Jugore që me përjashtim të tregtarëve serbë, të mos u jepnin asnjë kredi tregtarëve që i përkisnin kombësive të

⁴ AMPJ, V.1929, D.155, fl.27. Raport i Nezir Leskovikut, për ministrin e Punëve të Jashtme Iljaz Vrioni, 21.12.1928.

⁵ AMPJ, V.1932, D.156, fl.16. Raport i kryekonsullit shqiptar në Shkup Xhavit Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 30.9.1932.

⁶ *Archivio Storico Diplomatico di Ministero Affari Esteri, Roma* (më tej: AMAE), Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës italiane në Beograd drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë dhe konsullatës italiane në Manastir lidhur me politikën e qeverisë jugosllave ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi, 14.1.1930.

lartpërmendura. Sipas konsullatës italiane në Shkup midis Dhomës së Tregtisë, bankave dhe tregtarëve serbë ishte krijuar një qark që vinte duke u shtrënguar e duke kufizuar çdo veprimtari tregtare të shqiptarëve e maqedonasve, duke i detyruar këta që shpeshherë të falimentonin. Si rrjedhojë e këtyre masave, familjet e njohura tregtare që gëzonin reputacion në qarqet tregtare europiane, tani e kishin të pamundur të zhvillonin veprimtari tregtare dhe ishin të detyruar për të hequr dorë prej saj. Kështu, për këta tregtarë nuk mbetej gjë tjetër veçse ta braktisnin vendin e tyre.⁷ Megjithë përçapjet miqësore që konsulli i Shqipërisë në Shkup bëri pranë kolegut turk, me qëllim që ai të evitonte dhënien e vizave për shqiptarët e Kosovës, ky konsull hera-herës vazhdoi t'u jepte viza.⁸ Si rezultat edhe emigrimi i kosovarëve drejt Turqisë vazhdoi, ndonëse jo në mënyrë konstante. Megjithatë pati raste kur shumë familje që kishin emigruar në Turqi u rikthyen. Shkak ishte pakënaqësia ndaj qeverisë turke, e cila nuk i kishte mbajtur premtimet. Tokat që ajo u kishte shpërndarë emigrantëve, krahasuar me ato që kishin lënë në Kosovë ishin më të këqija. Një rol më vete luajti edhe fakti se, në këtë periudhë Ataturku po ndërmerre reforma drastike për laicizimin dhe oksidentalizimin e Turqisë. Menjëherë sapo emigrantët kishin hyrë në territorin turk, burrat ishin detyruar të hiqnin fesin, ndërsa gratë perçet. Këto veprime i kishin indinjuar emigrantët kosovarë, që ishin fanatikë dhe të lidhur pas traditës. Kjo binte në kundërshtim edhe me pritshmërinë e tyre, pasi propaganda jugosllave u kishte krijuar bindjen se, në Turqi feja mund të praktikohet më lehtë. Megjithatë, autoriteteve jugosllave nuk u erdhi keq për rikthimin e këtyre familjeve. Këto autoritete e shfrytëzuan mjeshtërisht këtë fenomen për të himnizuar epërsinë e lirisë që gjoja ekzistonte brenda Jugosllavisë dhe për të rritur numrin e “qytetarëve besnikë”.⁹ Nga ana tjetër, Ministria e Jashtme jugosllave, me anë të shtypit, i këshilloi nënshtetasit e saj që të mos shkonin në Turqi

⁷ AMAE, Fondi: Serie Política 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës mbretërore në Tiranë lidhur me politikën e qeverisë jugosllave ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi, 24.1.1930.

⁸ *Po aty*, Telegram i konsullatës italiane në Shkup drejtuar legatës mbretërore në Beograd dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, 23.6.1930.

⁹ *Po aty*, Fondi: Serie Política 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës mbretërore në Tiranë lidhur me emigrimin e shqiptarëve nga Jugosllavia, 2.9.1930.

pasi atje ishte e vështirë të sigurohej punë. Por një paralajmërim i tillë nuk vlente edhe për shqiptarët. Ministri i Shqipërisë në Beograd, Xhafer Vila i informuar për çështjen në fjalë nga konsulli i Shkupit, i tërhoqi vëmendjen homologut turk nga i cili mori sigurime formale se Ankaraja i kishte dhënë udhëzime kategorike konsullit në Shkup për të mos lëshuar viza për shqiptarët. Gjithashtu Xhafer Vila i kërkoi Tiranës që kjo situatë t'i bëhej e ditur edhe Romës, me lutjen që të ndërhynte sa më shpejt pranë qeverisë turke.¹⁰

Legata italiane në Tiranë ndiqte një politikë e cila ishte në favor të interesave shqiptare. Në kuadër të gjeopolitikës së saj edhe Roma ishte për qëndrueshmërinë demografike të Kosovës dhe oportunitetin që, në rast se emigrimi i kosovarëve do të ishte i pashmangshëm, më mirë ata të drejtoheshin drejt Shqipërisë. Një pikëpamjeje identike i përmbahej edhe qeveria shqiptare. Ajo këmbëngulte që shqiptarët e Kosovës, sa të ishte e mundur, të mbeteshin në territorin jugosllav dhe të ruanin karakterin e tyre kombëtar; në rast të kundërt ajo do të bënte çmos për ta lehtësuar instalimin e tyre në Shqipëri. Në kuadër të kësaj politike ajo kishte miratuar edhe një ligj, sipas të cilit çdo familjeje kosovare do t'i jepeshin: a) nga dy hektarë e gjysëm tokë shtetërore b) nga dyqind deri në treqindpesëdhjetë franga ari sipas numrit të anëtarëve, që do të përdroreshin për ndërtimin e shtëpisë, blerjen e bagëtisë dhe veglave të punës c) një ndihmë mujore prej pesë frangash ari për çdo anëtar të familjes deri sa të caktohej trualli për ndërtimin e shtëpisë. Kjo ndihmë do të vazhdonte edhe një vit pas instalimit.

Ambasadori italian në Tiranë i raportonte Romës se: “Nëse ne e vlerësojmë këtë ndihmë financiare me syrin tonë, ajo nuk është kushedi se çfar. Por, nëse llogaritet gjendja e këputur e bilancit të shtetit shqiptar dhe niveli i mjerueshëm i jetës së këtyre njerëzve, sigurisht që kjo mbështetje është diçka shumë e madhe”.¹¹ Kësaj linje të qeverisë shqiptare iu përmbajt edhe Ministria e Jashtme italiane. Ajo urdhëroi legatën e Ankarasë që të bënte përçapjet e duhura pranë qeverisë turke,

¹⁰ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës italiane në Beograd drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë lidhur me emigrimin e shqiptarëve drejt Turqisë, 19.12.1930.

¹¹ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës mbretërore italiane në Tiranë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë lidhur me emigrimin e popullsisë shqiptare të Kosovës në Turqi, 12.1.1931.

për të ndaluar dhënien e vizave për kosovarët. Kjo ministri i bënte të ditur kësaj legatë, se hyrja në Shqipëri e një numri të madh kosovarësh të cilët aspironin për t'u kthyer në tokat e tyre do të krijonte një motiv shqetësimi për Jugosllavinë. Lidhjet që ato do të ruanin me shqiptarët e mbetur në territorin jugosllav, do ta mbanin të ndezur irredentizmin në Kosovë. Me fjalë të tjera, vazhdonte më tej arsyetimi i Ministrisë së Jashtme italiane, duke u mirëpritur këta emigrantë në Shqipëri, do të frustoheshin qëllimet e Jugosllavisë. Pikëpamja e qeverisë italiane përputhej plotësisht me atë të qeverisë shqiptare, e cila bënte çmos që kosovarët të qëndronin në tokat e tyre.¹²

Roma bëri përpjekje për të krijuar një front bashkëpunimi midis Mbretit Zog dhe Hasan Prishtinës, që në këtë periudhë ishte përfaqësuesi më tipik i irredentizmit kosovar. Si ndërmjetës shërbeu përfaqësuesi i Italisë në Austri, i cili u përpoq të organizonte një takim midis Hasan Prishtinës dhe ministrit të Oborrit Mbretëror, Ekrem bej Libohovës. Në bisedat konfidenciale që Hasan Prishtina zhvilloi me ambasadorin italian në Vjenë, deklaroi se kishte rënë dakord me Fuad bej Dibrën e personalitete të tjera të Kosovës që brenda pak muajsh ai të vendosej në krye të një komiteti revolucionar. Qëllimi i këtij komiteti ishte krijimi i një organizimi ushtarak me shqiptarët e Kosovës që do të përdorej në rast të një konflikti të armatosur mes Italisë dhe Shqipërisë nga njëra anë dhe Jugosllavisë nga ana tjetër. Sipas raportit të ambasadorit italian në Vjenë, Maxoti, plani i veprimit të Hasan Prishtinës përfshinte këto pika:

1) Hasan Prishtina do të synonte të merrte nga Mustafa Qemal Ataturku dhe nga Fevzi Pasha, ministër i Luftës dhe Komandanti i Shtatmadhorisë Turke, miratimin për të organizuar me kosovarët e emigruar në Turqi disa kompani të armatosura dhe të siguronte lejen për t'i transportuar ata në Shqipëri për të luftuar kundër Jugosllavisë. Në kuadër të këtij plani Hasan Prishtina ishte duke shkëmbyer letra me sekretarin personal të Mustafa Qemalit, i cili ishte me prejardhje nga Shkupi. Pas një miratimi të tillë Hasan Prishtina besonte se mund të organizonte një trupë prej rreth 12.000 forcash.

¹² *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës mbretërore italiane në Ankara lidhur me emigrimin e popullsisë shqiptare të Kosovës në Turqi, 19.1.1931.

2) Hasan Prishtina synonte që me anë të miqve të tij ta nxiste qeverinë turke që të bënte deklarata politike, për të ndaluar emigrimin e shqiptarëve nga Kosova.

3) Duke marrë parasysh njohjet që Hasan Prishtina kishte me disa përfaqësues të elitës politike turke, ai do të fillonte një fushatë kundër Jugosllavisë. Në mënyrë të veçantë do të analizoheshin gjerësisht masat policeske që Jugosllavia përdorte kundër shqiptarëve.

4) Hasan Prishtina gjendej në tratativa për të lidhur një aleancë me organizatën maqedone të Mihailofit dhe me maqedonët federalistë.

Pasi kushti thelbësor për jetësimin e këtij programi ishte gadishmëria dhe inkurajimi i qeverisë shqiptare, Hasan Prishtina i kishte rrëfyer në konfidencë Maxotit se Mbreti Zog i kishte ofruar me anë të doktor Leo Frojndlih, të pranonte drejtimin e komitetit revolucionar të Kosovës. Hasan Prishtina i deklaroi gjithashtu Maxotit se nëse Italia do të luante rolin e ndërmjetëses dhe do t'i kërkonte Mbretit Zog miratimin e programit të mësipërm, ai ishte i gatshëm të bashkëpunonte.¹³

Plani i Hasan Prishtinës gjeti mbështetje të plotë nga Roma. Ministri italian i Punëve të Jashtme i dërgoi Maxotit udhëzimin se veprimtaria e irredentistëve kosovarë gëzonte plotësisht simpatinë e qeverisë fashiste, me kushtin që paraprakisht ata të ndërmerrnin veprime konkrete. Megjithëse Roma e shikonte me rezerva besimin e tepruar të Hasan Prishtinës në ndihmën që priste nga elita politike turke,¹⁴ ajo luajti një rol aktiv në këtë drejtim. Ambasadori italian në Ankara u udhëzua për të hetuar predispozitat reale të qeverisë turke. Veçanërisht, për të vërtetuar nëse sigurimet e dhëna nga ministri i Turqisë në Beograd, i cili i kishte premtuar ambasadorit italian se do të pengonte lëshimin e vizave për hyrjen e kosovarëve në territorin turk, ishin mbajtur në të vërtetë nga qeveria turke.

Më 7 mars 1931, ambasadori i Italisë në Ankara zhvilloi një bisedë me ministrin e Jashtëm Tefik Beun, të cilit i rikujtoi sigurimet e dhëna për të penguar hyrjen e emigrantëve kosovarë në Turqi dhe për t'u krijuar atyre kushte lehtësuese që të vendoseshin në Shqipëri. Ministri turk i pranoi pretendimet e ambasadorit italian dhe deklaroi se qeveria turke do

¹³ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës Mbretërore italiane në Tiranë, 1931.

¹⁴ *Po aty*.

të refuzonte çdo vizë hyrëse për kosovarët. Ky qëndrim i qeverisë turke, sipas Tevfik Beut, ishte në përputhje me programin e nacionalizimit që ishte duke ndjekur regjimi qemalist, i cili ishte i prirur të pengonte formimin e pakicave të reja. Ai e mohoi faktin se konsullata turke në Shkup u krijonte lehtësi kosovarëve për të emigruar në Turqi. Përkundrazi, ai kishte dhënë udhëzime për t'i refuzuar ata, duke gjetur si pretekst moszotërimin e gjuhës turke. Sipas tij, ky ishte edhe kriteri që do t'i dallonte më mirë të dyja racat.

Premtimet e ministrit turk, konsideroheshin nga Ministria e Jashtme italiane si qëndrime me kahje të kundërt midis asaj që thuhej dhe veprimeve konkrete. Prandaj, për të vërtetuar atë që ndodhte në terren, kjo ministri udhëzoi legatën italiane në Beograd që të mblidhte fakte dhe që konsullin turk të Shkupit ta mbante nën kontroll.¹⁵ Nuk zgjati shumë dhe në verë të vitit 1931, konsulli i Italisë në Shkup, i raportoi Romës se kohët e fundit për motive stinore eksodi i kosovarëve drejt Turqisë kishte rinisur me intensitet. Sipas konsullit italian, konsullata turke e Shkupit në kundërshtim me premtimet e dhëna nuk i kishte pyetur emigrantët lidhur me zotërimin e gjuhës turke. Për më tepër konsulli i lartpërmendur i mëshonte faktit se, tashmë nuk kishte asnjë dyshim se konsullata turke krijonte kushte lehtësuese për eksodin e shqiptarëve drejt Turqisë. Ai sillte edhe një dëshmi të Feruz Beut, ish-konsullit turk në Shkup, i cili para se të transferohej në Amsterdam, i kishte deklaruar në mënyrë konfidenciale përkthyesit të konsullatës italiane se: “Qeveria ime ka nevojë absolute për njerëz dhe unë kam marrë udhëzime sekrete për të inkurajuar eksodin e popullsisë myslimane”. Veç kësaj ai kishte shtuar se qëllimi i qeverisë së tij ishte të bënte propagandë edhe mes myslimanëve të vendosur në Bullgari që ata të drejtoheshin në distriktet kufitare të Adrianopojës. “Me të dhënat e paraqitura më lart,-i shkruante ambasadori italian në Beograd MPJ,-mendoj se nuk është e vështirë të provohet, se sa të papërpikta, në mos ekuivoke, janë udhëzimet e qeverisë turke për përfaqësuesin e saj në Jugosllavi”.¹⁶

¹⁵ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës Mbretërore italiane në Beograd dhe Tiranë lidhur me emigrimin e popullsisë shqiptare të Kosovës, 21.3.1931.

¹⁶ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës Mbretërore italiane në Beograd drejtuar Ministrisë së Punëve të

Ndërhyrja e diplomacisë italiane pas këtyre fakteve që e menjëhershme. Ambasadori i Italisë në Ankara u takua me Tevfik Beun, të cilit i tërhoqi vëmendjen mbi emigrimin e shqiptarëve të Kosovës, duke e vënë theksin tek antagonizmi mes sigurimeve të dhëna prej tij dhe realitetit në terren. Por ministri turk u justifikua me faktin se mes elementit shqiptar dhe atij turk ishte krijuar një lloj pështjellimi. Atij nuk i dukeshin bindëse faktet e dhëna. Prandaj, ambasadori italian në Ankara kërkoi nga ministria informacione më konkrete. Sipas ministrit turk, i cili luante rolin e të painformuarit, këto informacione do të shërbenin për ta pasur më të lehtë ndërhyrjen pranë konsullatës së Shkupit. Edhe një herë ai i përsëriti diplomatit italian se një emigrim i pakicave të çfarëdolloj race në Turqi, edhe nëse i përkisnin religjionit islam, nuk ishte aspak i dëshiruar nga qeveria turke. Sipas tij, duke pasur parasysh kushtet ekonomike të vendit, një shtim i popullsisë do ta rëndonte situatën kritike në të cilën ndodhej Turqia. Një numër i madh emigrantësh do të rriste numrin e të papunëve dhe do të bëheshin barrë për administratën, shtuar edhe rrezikun e përhapjes së sëmundjeve epidemike në një vend si Turqia ku kushtet higjienike linin për të dëshiruar. Këtyre konsideratave, ministri turk u shtoi edhe “habinë” për veprimet e konsullit të Shkupit, i cili inkurajonte eksodin e popullsisë myslimane drejt Anadollit. Këto veprime, sipas tij, ishin në kundërshtim me direktivat e qeverisë turke. Megjithatë ai i deklaroi ambasadorit italian se do t’i tërhiqte vëmendjen ministrit të Turqisë në Beograd.¹⁷

Një problem po aq shqetësues për qeverinë shqiptare vazhdoi të mbetej emigrimi i popullsisë shqiptare të Çamërisë. Ministri i Jashtëm Hysen Vrioni informoi ambasadorin italian në Tiranë, Pietro Cuaroni se autoritetet greke, me anë të ndonjë hoxhe, kishin nisur një propagandë intensive mes popullsisë shqiptare të Çamërisë, duke i nxitur ata që të emigronin në Turqi. Qeveria shqiptare e shqetësuar për këtë shkombëtarizim të një territori historikisht shqiptar, kërkoi nga Roma që në mënyrë analoge, ashtu siç kishte bërë për kosovarët, të bënte përçapjet

Jashtme në Romë lidhur me emigrimin e shqiptarëve të Kosovës drejt Turqisë, 18.6.1931.

¹⁷ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës italiane në Ankara drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me emigrimin e shqiptarëve të Kosovës drejt Turqisë, 1.8.1931.

e duhura pranë qeverisë turke.¹⁸ Meqenëse bëhej fjalë për dy situata plotësisht të njëjta dhe që përlligjin të njëjtin qëndrim, Ministria e Jashtme italiane autorizoi ambasadorin e saj në Ankara që të ndërhynte pranë qeverisë turke, me qëllim që ajo të udhëzonte autoritetet e saj diplomatike në Greqi që të refuzonin lëshimin e vizave për shqiptarët e Çamërisë.¹⁹ Por, kushte të tilla “lehtësuese” për të nxitur emigrimin ndiqte edhe qeveria greke.²⁰ Ambasada italiane në Athinë informoi Ministrinë e Jashtme se emigrimi i shqiptarëve të Çamërisë drejt Turqisë u ishte diktuar atyre si rezultat i gjendjes së rëndë që ishte krijuar si pasojë e shpronësimit dhe ligjit që favorizonte refugjatët grekë të ardhur nga Azia e Vogël. Shqiptarët gjendeshin në kushte tepër të vështira jetësore edhe për shkak të marrëdhënieve të acaruar mes qeverisë shqiptare dhe asaj greke. Shtypi grek e quante mision parësor të kapte rastin më të vogël për t’i acaruar përherë e më tepër marrëdhëniet mes dy vendeve. “Qeveria greke,-vijonte më tej raporti i legatës italiane në Athinë,-duke zbatuar ligjin e shpronësimeve, tejmase bolshevik, kishte arritur të krijonte një gjendje jetese të pamundur për shumë fatkeqë, dhe indirekt t’i shtrëngonte ata t’i kërkonin gjetkë mjetet dhe mundësinë për jetesë dhe për punë”.²¹ Legata italiane në Athinë mori udhëzime të qarta nga Roma për të ndjekur me kujdes propagandën e qeverisë greke ndërmjet popullsisë shqiptare të Çamërisë dhe sidomos gjerësinë e lëvizjes së eksodit që do të rezultonte prej kësaj propagande antishqiptare.²²

¹⁸ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës italiane në Tiranë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me emigrimin e shqiptarëve të Çamërisë drejt Turqisë, 18.8.1931.

¹⁹ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës italiane në Ankara lidhur me emigrimin e shqiptarëve të Çamërisë drejt Turqisë, 27.8.1931.

²⁰ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës Mbretërore në Tiranë lidhur me emigracionin e shqiptarëve nga Çamëria, 16.12.1931.

²¹ *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i legatës italiane në Athinë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë lidhur me politikën e qeverisë greke ndaj popullsisë shqiptare të Çamërisë, 18.12.1931.

²² *Po aty*, Fondi: Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 786, Fasc.775. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar legatës Mbretërore në Athinë

Për të parandaluar shpërnguljen e popullsisë kosovare nga trojet e saj, qeveria shqiptare bëri vazhdimisht përpjekje edhe pranë Ankarasë. Më 19 nëntor 1932, Nezir Leskoviku u urdhërua që të takohej me ministrin e Jashtëm Tevfik Rüştü Aras dhe t'i kërkonte atij që konsullatat turke në Jugosllavi të ndalonin dhënien e vizave për kosovarët. Tevfik Rüştü Beu i deklaroi Nezir Leskovikut se qeveria turke kishte dhënë urdhër për të mos pranuar asnjë emigrant kosovar dhe e siguroi diplomatin shqiptar se nuk do të lejonte në asnjë mënyrë që konsullatat turke në Jugosllavi, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë, të jepnin viza për shqiptarët. Sipas Nezir Leskovikut, fakti se ato ditë u ishte refuzuar dhënia e vizës nga ambasada turke në Beograd 10 familjeve nga Peja, i vërtetonte plotësisht premtimet e dhëna nga Tevfik Rüştü Beu.²³ Por kjo situatë ishte vetëm një masë e përkohshme dhe nuk vazhdoi gjatë.

Më 28 shkurt 1933, Tevfik Rüştü Aras, me sugjerim të Ataturkut vizitoi Beogradin. Pasi u prit nga autoritetet më të larta vendase, ai filloi bisedimet me Begolub Jevtiq-in për nënshkrimin e një pakti mossulmimi dhe miqësie midis Turqisë dhe Jugosllavisë.²⁴ Në kuadër të këtyre bisedimeve, autoritetet jugosllave shfrytëzuan rastin për të diskutuar edhe për shpërnguljen eventuale të shqiptarëve në Anadoll. Menjëherë pas këtij takimi, ministri i Jashtëm i Jugosllavisë i dërgoi përfaqësisë së Stambollit një telegram sekret, ku e urdhëroi se çdo shqiptari që kishte autoritet në Kosovë dhe që vizitonte Turqinë duhet t'i bëhej i pamundur rikthimi në vendlindje.²⁵

Qeveria shqiptare ndiqte me shqetësim të madh çdo afrim të Turqisë me Jugosllavinë. Një bashkëpunim i mundshëm midis këtyre dy shteteve ishte në disfavor të interesave të kombit shqiptar.

Më 28 shtator 1933, konsullata shqiptare e Stambollit njoftoi Ministrinë e Jashtme se Mbreti Aleksandër i Jugosllavisë së shpejti do të

lidhur me ndërhyrjen e qeverisë italiane pranë Ankarasë për të parandaluar favorizimin e emigrimit të popullsisë shqiptare drejt Turqisë, 19.12.1931.

²³ *Po aty*, V.1932, D.156, fl.28. Raport i Nezir Leskovikut, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 30.11.1932.

²⁴ Këto bisedime u finalizuan më 27 nëntor 1933, me nënshkrimin e një traktati miqësie dhe mosagresioni midis Turqisë dhe Jugosllavisë. *Shih: İsmail Soysal, Tariççeleri ve Açıklamaları ile Birlikte Türkiye'nin Siyasal Andlaşmaları*, I. Cilt (1920-1945), Ankara: TTK, 1989, s. 441-446.

²⁵ Hakif Bajrami, "Konventa Jugosllavo-Turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve", *Gjurmime albanologjike*, nr.XII-1982, Prishtinë 1983, f.244-245.

zhvillonte një vizitë zyrtare në Turqi. Ai do të ishte mik personal i Presidentit të Republikës Turke, Mustafa Qemalit.²⁶ Vajtja e tij në Turqi, sipas të gjitha gjasave, do të kishte një rëndësi të madhe politike. Prandaj, Ministria e Jashtme e udhëzoi konsullatën shqiptare të bënte kujdes për të mësuar çdo detaj rreth qëllimit të kësaj vizite.²⁷

Për të parandaluar emigrimin e kosovarëve drejt Turqisë, Mbreti Zog ndërhyri edhe personalisht pranë Ataturkut. Në vitin 1934, ai i adresoi atij një letër, ku i kërkoi hapur që qeveria turke të mos pranonte asnjë kosovar në territorin e saj.²⁸

Si rezultat i shpronësimeve dhe dhunës së ushtruar nga autoritetet jugosllave, gjatë vitit 1935 me qindra familje shqiptare vazhduan të emigronin drejt Turqisë. Ministri shqiptar në Beograd, Rauf Fico, informoi MPJ se shqiptarët e Kosovës, të gjendur në një pozitë të vështirë ekonomike, donin të vinin në Shqipëri. Por, meqë qeveria shqiptare nuk i pranonte, ata ishin të detyruar të niseshin drejt Turqisë. Sado që qeveria turke kishte deklaruar se nuk do t'i pranonte emigrantët shqiptarë, disa kosovarë nga Prizreni, Prishtina dhe Gjilani që flisnin turqisht paraqiteshin në konsullatat turke dhe pretendonin se ishin turq, dhe këto të fundit u jepnin viza. Ajo që e bënte edhe më serioze këtë situatë ishte një fjalim i ministrit të Brendshëm turk Şükrü Kaya në Asamblenë e Madhe Kombëtare, i cili kishte deklaruar se nga Jugosllavia do të sillleshin 800.000 emigrantë "turq". Kjo shprehje i shtoi akoma më shumë dyshimet e autoriteteve shqiptare tek qeveria turke. Sipas Rauf Ficos, ajo mjaftonte për të treguar se deri në ç'pikë do të mbaheshin "premtimet" e Ankarasë.²⁹

Përballë kësaj situatë, qeveria shqiptare, mori masa emergjente. Ajo krijoi Drejtorinë e Reformës Agrare, e cila kishte si qëllim sistemimin e

²⁶ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), V.1933, D.243, fl.56, Raport i konsullatës shqiptare në Stamboll, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 28.9.1933.

²⁷ *Po aty*, V.1933, D.243, fl.54. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për konsullatën shqiptare në Stamboll, 29.9.1933.

²⁸ *Po aty*, V.1934, D.142, fl.230-231. Letër e shkruar nga Mbreti Zog në gjuhën osmane, për Mustafa Qemal Ataturkun.

²⁹ *Po aty*, V.1935, D.185, fl.34. Raport i ministrit shqiptar në Beograd Rauf Fico, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 5.4.1935.

emigrantëve kosovarë në brendësi të territorit shqiptar.³⁰ Një detyrë tjetër e kësaj drejtorie ishte sidomos parandalimi i shpërnguljes së tyre. Në këtë kuadër, më 17 maj 1935, ajo njoftoi kryekonsullatën Mbretërore në Shkup se për të parandaluar emigrimin e kosovarëve drejt Turqisë, i kishte dërguar kësaj kryekonsullate 10.000 fr.ari dhe Ferhat bej Dragës 4000 fr.ari.³¹

Në funksion të politikës së tyre diversive, me qëllim për të krijuar tension në marrëdhëniet shqiptaro-turke, diplomatët e Beogradit në tetor të vitit 1935 sajuan një incident mes qeverisë shqiptare dhe legatës turke. Ata përhapën fjalë, sikur shqiptarët ishin zemëruar me diplomatët turq, për shkak se në një film që u shfaq në këtë legatë, diplomatëve jugosllavë u ishte rezervuar vendi më i mirë. Në fakt në Tiranë nuk ishte konsideruar asgjë qenësore. Por, synimi i diplomatëve jugosllavë ishte që me çdo kusht të shkaktohej tension ndërshtetëror me qëllim që shqiptarët e Jugosllavisë t'i kishin “dyert e hapura” për t'u shpërngulur në Turqi.³²

Me ardhjen në fuqi të qeverisë së Stojadinoviç-it në Ministrinë e Jashtme të Jugosllavisë filluan konsultime intensive lidhur me shpërnguljen e shqiptarëve drejt Turqisë. Në këtë kuadër, në korrik të vitit 1935 u formua një komitet ilegal, i cili krahas diskutimeve që do të bënte me “Klubin Kulturor Serb”, duhet të përgatiste edhe një projekt për shpërnguljen e shqiptarëve.³³ Në muajin shtator maketi ishte gati, kështu që menjëherë filluan diskutimet ndërmjet ministrive të interesuara.³⁴ Për këtë, u krijua dhe një Komitet ndërministror, në përbërje të të cilit bënë pjesë përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ndërtimit dhe Komunikacionit dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë.

³⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f.299.

³¹ *AMPJ*, V.1935, D.185, fl.67. Letër e Drejtorisë së Reformës Agrare, për kryekonsullatën Mbretërore në Shkup, 17.5.1935.

³² Hakif Bajrami, “Rreth përgatitjes së Konventës Jugosllavo-Turke për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi (1938)”, *Gjurmime albanologjike*, nr.XVIII-1988, Prishtinë 1989, f.220.

³³ Disa nga projektet, memorandumet dhe elaboratet e “Klubit Kulturor Serb” dhe “Akademisë së Shkencave të Serbisë” për spastrimin dhe dëbimin e popullsisë shqiptare nga Kosova u hartuan pikërisht në këtë periudhë. *Shih*: Rexhep Qosja, *Shpërngulja e shqiptarëve sipas programeve kombëtare serbe: Naçertanija e Ilija Garashaninit; Projektet e Vasa Çubrilloviqit, etj*, Tiranë: Toena, 2004.

³⁴ H. Bajrami, “Konventa Jugosllavo-Turke...”, f.245.

Mbledhja e parë e këtij Komiteti, u zhvillua më 1 tetor 1935 dhe vendosi dy pika kryesore rreth shpërnguljes së shqiptarëve: a) duke nënshkruar një konventë ndërshtetërore me Turqinë dhe b) pjesa që mbetej të zhvendosej në brendësi të Jugosllavisë dhe atje, në sajë të dominimit të elementit sllav, me kalimin e kohës të asimilohej.³⁵ Komiteti, sipas propozimit të ekspertëve, mori përsipër organizimin e një Inspektoriatit Suprem, me seli në Shkup dhe me disa inspektoriate lëvizëse për t'ua lehtësuar shqiptarëve formalitetet zyrtare për shpërngulje në shkallë spastrimesh masive.³⁶ Në mbledhjen ndërministrorë në Beograd ishte theksuar ndër të tjera se në Shkup, disa kohë më parë, kishte qëndruar me cilësinë e gazetarit Yaşar Nabi-u (Jashar Nabi), një ekspert i lartë për informim dhe propagandë i Ministrisë së Brendshme të Turqisë. Ky ishte dërguar me mision special nga Ankaraja për të hartuar një relacion mbi gjendjen e popullsisë turke në Ballkan. Pas kthimit në Turqi, Yaşar Nabi-u botoi një studim të hollësishëm mbi kushtet politike dhe social-ekonomike të popullsisë myslimane (turko-shqiptare) të Jugosllavisë.³⁷ Sipas tij, kjo popullsi që herët kishte qenë e detyruar të shpërngulej nga vendbanimet e saj, për shkak të konfiskimit të tokave nga autoritetet vendase, me preteksin e aplikimit të reformës agrare. Nga konstatimet e bëra, numri i përgjithshëm i kësaj popullsie shkonte deri në 500.000 banorë nga të cilët më shumë se sa gjysma, megjithëse për nga raca dhe gjuha ishin shqiptarë, kulturalisht anonin nga Turqia. Prandaj, sipas tij, më shumë se sa pakicë e Shqipërisë, ata dëshironin të ishin pakicë e Republikës Turke dhe, në një të ardhme të afërt të emigronin drejt Anadollit.³⁸ Yaşar Nabi-u, e vinte theksin se po të ndiqej një politikë më e "drejtë", me kusht që fëmijët e të ardhurve të kalonin në sistemin arsimor dhe të turqizoheshin, pas dy brezash nga këta emigrantë Turqia, mund të përftonte një popullsi vitale, tej mase besnike dhe shumë punëtore.³⁹

Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia kishte tërhequr edhe vëmendjen e Anglisë. Me miratimin e Foreign Office, ambasadori anglez në Shqipëri, zhvilloi një vizitë në Beograd. Atje ai u takua me disa funksionarë të lartë midis të cilëve edhe me kryeministrin Stojadinović.

³⁵ Po aty, f.246.

³⁶ H. Bajrami, "Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi...", f.146.

³⁷ Yaşar Nabi, *Balkanlar ve Türklük*, Ankara: Ulus Basimevi, 1936.

³⁸ Po aty, s.191.

³⁹ Po aty, s.204.

Në bisedën që ata zhvilluan diskutuan edhe çështjen e trajtimit të minoritetit shqiptar në Jugosllavi. Stojadinoviç-i e mohoi kategorikisht që autoritetet lokale kishin bërë presion që t'i detyronin kosovarët të emigronin. Sipas tij, ligji i reformës agrare kishte gjetur një zbatim të përgjithshëm dhe nuk kishte si qëllim të dëmtonte fshatarët shqiptarë. Megjithëse qeveria jugosllave nuk dëshironte të merrte masa për t'i shpronësuar kosovarët, ajo nuk mund ta mohonte faktin që, preferonte largimin e tyre. Kur ambasadori anglez i tërhoqi vëmendjen Stojadinoviç-it se një vend i vogël dhe i varfër si Shqipëria nuk mund të gjente mjete financiare për të përballuar një numër kaq të madh emigrantësh, ai deklaroi se qeveria jugosllave ishte e gatshme t'i ofronte hua Shqipërisë për kolonizimin e kosovarëve. Komenti që i duhej bërë kësaj deklaratë, i raportonte ambasadori anglez Foreign Office, ishte se Jugosllavia kishte aq dëshirë për të asgjësuar kosovarët sa që ishte e gatshme për të dhënë të holla për t'i vendosur në një shtet tjetër. Ndërsa mohimi se ajo nuk kishte qëllim që atyre t'u merrte tokat, ishte i pandershëm.⁴⁰

Më 29 qershor 1936, legata britanike në Durrës i raportoi Foreign Office se për herë të parë, Jugosllavia i kishte drejtuar qeverisë shqiptare një kërkesë zyrtare për pranimin e një kontigjenti të madh emigrantësh kosovarë prej 40.000-50.000 personash. Nga burime të tjera, kjo legatë kishte informacion se një shifër akoma më e madhe i ishte propozuar edhe Turqisë. Pikëpamja shqiptare, sipas raportit, ishte se me përjashtim të disa lokaliteteve ku predominonte elementi turk e gjithë popullsia tjetër e Kosovës ishte shqiptare. Ndërsa pikëpamja e Jugosllavisë, e cila deklaronte se nuk po ushtronte asnjë presion mbi myslimanët që të braktisnin tokat e tyre, ishte se që nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore këta njerëz kishin në kokë vetëm një dëshirë, të largoheshin nga tokat e të krishterëve dhe të kërkonin azil politik në Turqi, në “vendin e tyre racial”. Kjo fushatë e Beogradit kishte si synim kryesor spastrimin dhe zëvendësimin e elementit shqiptar me kolonë malazezë. Diplomatët anglezë pohonin se jugosllavët, në këtë çështje po tregoheshin shumë të papjekur politikisht. Sipas tyre një politikë më e butë do ta bënte Kosovën një burim të madh fuqie dhe, Shqipërinë mike. Nuk ishte përtej mundësive të Jugosllavisë të ndiqte një diplomaci të urtë, duke krijuar

⁴⁰ *British National Archives, London, Public Record Office; Foreign Office (më tej: FO) FO/371/19477. Raport i ambasadorit anglez në Durrës për FO, 6.11.1935.*

kushte në Kosovë që jo vetëm t'i bënte shqiptarët të qëndronin aty ku ishin por të frymëzonin edhe bashkëfetarët e tyre përtej kufirit, të cilët nuk ishin në gjendje aq të mirë sa kosovarët.⁴¹ Në përgjigje të këtij raporti, Foreign Office, e udhëzoi përfaqësuesin britanik në Beograd se, qeveria angleze nuk kishte dëshirë të ndërhynte zyrtarisht tek qeveria jugosllave, por, nëse kjo legatë ishte dakord me pikëpamjet e mësipërme të Hodgson-it ai mund të zhvillonte një bisedë jo formale me ministrin e Jashtëm të Jugosllavisë.⁴²

Në verën e vitit 1936, midis përfaqësuesve konsullorë të Jugosllavisë dhe Turqisë u arrit një marrëveshje sekrete në formë akordi. Kjo marrëveshje kishte 6 pika dhe parashikonte shpërnguljen e 200.000 shqiptarëve, kryesisht nga rajoni i Dukagjinit. Ky akord, sipas studiuesit Hakif Bajrami, nuk është nënshkruar, por në fund të dokumentit sekret vërehet një shkrim prej dy fjalish nga dora e Millan Stojadinoviç-it, ku në formë direktive thuhet se: "Nuk duhet humbur kohë, çështjen shqiptare duhet ta likuidojmë si therrën në fushë".⁴³

Në këtë kuadër, diplomacia e shtetit jugosllav e intensifikoi veprimtarinë e saj në drejtim të lidhjes së një marrëveshjeje me Turqinë. Tratativat jugosllavo-turke i konfirmonte edhe ambasadori anglez në Beograd. Ai i raportoi Foreign Office se ambasadori turk, Hajdar Beu, i kishte deklaruar se të dy qeveritë e interesuara ishin duke zhvilluar bisedime lidhur me ndarjen e përgjegjësive dhe për shpenzimet që duheshin kryer. Sipas Hajdar Beut, qeveria turke do të pranonte vetëm myslimanë që ishin me origjinë turke e që flisnin turqisht dhe jo shqiptarë. Ai mendonte se në krahinën e Kosovës kishte rreth 200.000 turq, 30.000-40.000 serb myslimanë që flisnin turqisht dhe 600.000 kosovarë. Sipas ambasadorit anglez, autoritetet jugosllave po ushtronin mbi popullsinë shqiptare një trajtim që i privonte ata nga mjetet e jetesës dhe që nuk i linte alternativë tjetër veçse të emigronin. Ai i shihte me skepticizëm ankesat e sekretarit të Përgjithshëm të MPJ jugosllave Martinac, se popullsia shqiptare ishte primitive, nuk respektonte ligjet dhe se të gjitha përpjekjet për t'i mësuar nuk kishin pasur efekt.

⁴¹ FO 371/20358. Raport i ambasadorit anglez në Durrës R.M.Hodgson për Eden, 29.6.1936.

⁴² FO 371/20358. Letër e Foreign Office për ambasadorin anglez në Beograd, 15.7.1936.

⁴³ H. Bajrami, "Rreth përgatitjes së Konventës Jugosllavo-Turke...", art. i cit., f.221.

Autoritetet jugosllave, sipas tij, ishin duke ndjekur një politikë të asgjësimit progresiv të këtij minoriteti. Në mbyllje të raportit, ai i propozonte Foreign Office, që për këtë problem t'u deklaronte funksionarëve jugosllavë se nuk ishte në interes të Jugosllavisë që popullsia myslimane shqiptare të vihej në një pozitë të tillë, që të detyrohej të emigronte drejt Turqisë.⁴⁴

Më 4 nëntor 1936, i Ngarkuari me Punë i Shqipërisë në Beograd, Sermed Xhaxhuli informoi ministrin e Jashtëm se kryeministri i Jugosllavisë Stojadinoviç do të zhvillonte një vizitë zyrtare në Ankara. Nga burime të sigurta, ai kishte mësuar se krahas një marrëveshjeje tregtare dhe lundrimi me Turqinë, qëllimi kryesor i vizitës së Stojadinoviç-it do të ishte nënshkrimi i një konvente emigrimi lidhur me "turqit" e Kosovës.⁴⁵ Pas kësaj vizite, qeverisë shqiptare i erdhën informata nga burime të ndryshme se në Ankara ishte lidhur edhe një konventë për shpërnguljen e kosovarëve. Prandaj, ajo urdhëroi kryekonsullatën shqiptare në Stamboll të zhvillonte hetime dhe që të njoftonte sa më shpejt mbi këtë çështje.⁴⁶ Të nesërmen, kryekonsulli shqiptar, Asaf Xhaxhuli, i raportoi ministrit të Jashtëm mbi vërtetësinë e lidhjes së një konvente jugosllavo-turke.⁴⁷

Pritja entuziaste që tregoi qeveria turke ndaj Stojadinoviç-it ngjalli kënaqësi të madhe tek qarqet jugosllave. Audiencia prej dy orësh tek Ataturku ishte shumë sinjifikative për interesat e përbashkëta që kishin këto dy shtete.⁴⁸

Pas kthimit në Beograd, ministri shqiptar Rauf Fico, i raportoi Ministrisë së Jashtme se në bisedën që kishte zhvilluar me Stojadinoviç-in, ky e kishte mohuar nënshkrimin e një konvente me Turqinë, por nuk kishte munguar të pohonte faktin se atje (në Ankara-H.B.) ishte biseduar rreth një marrëveshjeje tjetër, që kishte për qëllim instalimin e shtetasve

⁴⁴ FO 371/20358. Raport i ambasadorit anglez në Beograd për FO, 22.7.1936.

⁴⁵ AMPJ, V.1936, D.165, fl.219. Raport i të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Beograd Sermed Xhaxhuli, për ministrin e Jashtëm Fuad Asllani, 4.11.1936.

⁴⁶ Po aty, V.1936, D.165, fl.230. Letër e MPJ për kryekonsullatën shqiptare në Stamboll, 14.11.1936.

⁴⁷ Po aty, V.1936, D.165, fl.232. Letër e kryekonsullit shqiptar në Stamboll, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme, 15.11.1936.

⁴⁸ Po aty, V.1936, D.84, fl.298-299. Raport i të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Beograd Sermed Xhaxhuli, për ministrin e Jashtëm Fuad Asllani.

respektivë në Turqi.⁴⁹ Këto deklarata diplomatike të Stojadinoviç-it shumë shpejt u vërtetuan se s'ishin gjë tjetër veçse një përpjekje për ta fshehur të vërtetën. Një dashamirës i qeverisë shqiptare njoftoi kofidencialisht Asaf Xhaxhulin se një personalitet i MPJ turke i kishte thënë se, marrëveshja midis Turqisë dhe Jugosllavisë ishte e vërtetë dhe se të dyja palët ishin në bisedime për të gjetur mënyrën e shpërblimit të tokave dhe sigurimin e të hollave që do të shpenzoheshin për shpërnguljen dhe instalimin e kosovarëve në Turqi.⁵⁰ Kopjen e letrës së mësipërme të kryekonsullatës shqiptare të Stambollit, ku bëhej fjalë mbi marrëveshjen turko-jugosllave,⁵¹ Zyra Sekrete ia shpërndau edhe disa përfaqësive shqiptare, me qëllim që ato të ndërhyenin pranë qeverive ku ishin akredituar për ta parandaluar zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Meqë Konti Çiano së shpejti do të takohej me Tevfik Rüşti Aras-in, përfaqësuesi i Shqipërisë në Romë iu lut atij për të ndërmjetësuar pranë ministrit turk, me qëllim që Ankaraja të hiqte dorë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje. Konti Çiano e dëgjoi me vëmendje përfaqësuesin shqiptar dhe i premtoi se jo vetëm që do të bisedonte me Tevfik Rüşti Aras-in por, ai do të ngarkonte edhe ministrin e Italisë në Beograd, që këtë çështje ta bisedonte dhe me Stojadinoviç-in.⁵²

Për të mbrojtur popullsinë kosovare, qeveria shqiptare krijoi një komision të posaçëm, i cili u mblodh më 6, 7 dhe 11 janar 1937 nën kryesinë e ministrit të Jashtëm Ekrem Libohova, me anëtarë Rauf Fico në

⁴⁹ *Po aty*, V.1936, D.165, fl.247. Raport i ministrit shqiptar në Beograd Rauf Fico, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 4.12.1936.

⁵⁰ *Po aty*, V.1936, D.146, fl.280. Letër e kryekonsullit shqiptar në Stamboll, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme, 24.12.1936.

⁵¹ Sipas studiuesit Vuk Vinaver negociatat rreth shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova s'kanë qenë ndonjë e fshehtë e ruajtur rreptë. I Ngarkuari hungarez në Romë në shkurt të vitit 1937 mori vesh se ishte lidhur një marrëveshje jugosllavo-turke mbi shpërnguljen e shqiptarëve. Më 15 shkurt 1937, ministri i Shqipërisë në Beograd, Rauf Fico, i ishte ankuar kolegut të tij hungarez se Stojadinoviç në tetor 1936 kishte diskutuar në Ankara për të lidhur një konventë. Por, atëherë Turqia kishte refuzuar energjikisht që t'i pranonte shqiptarët, duke mos dëshiruar t'i bënte keq Shqipërisë. *Shih*: Vuk Vinaver, "Çështja shqiptare në shtypin e PKJ (1919-1939)", *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr.1, 1971, Prishtinë 1972, f.93.

⁵² *AMPJ*, V.1937, D.126, fl.25. Letër e përfaqësuesit shqiptar në Romë, për ministrin e Punëve të Jashtme Ekrem Libohova, 2.2.1937.

dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë në Beograd, Eqrem Vlorën sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme dhe Hamdi Karazin zëvendës drejtor në MPJ për punët e Lidhjes së Kombeve. Komisioni, pasi konstatoi politikën shkombëtarizuese jugosllave në Kosovë dhe synimin për shpërnguljen e tyre në Turqi, e gjykoji të arsyeshme të hartonte këtë program pune:

I. Të vazhdonte organizimi i përpjekjeve për mbrojtjen e elementit shqiptar në Jugosllavi, duke kundërshtuar emigrimin e tij kudoqoftë. Për këtë duhej: të organizoheshin elementët nacionalistë shqiptarë të Kosovës; të organizohej rinia intelektuale e Kosovës duke pasur organin e saj në Jugosllavi në formën e një fletoreje ose reviste kulturore letrare; të botohej një organ politik kosovar në qendrën e Lidhjes së Kombeve që të përkrahte këtë fushatë për organizimin, mbrojtjen dhe kundërshtimin e emigrimit, duke pasqyruar në botë gjendjen e kosovarëve; të kërkohej eventualisht, me ndërmjetësinë e kroatëve, një bashkëpunim me elementët disidentë bullgaro-maqedonas të Jugosllavisë.

II-Duke pasur parasysh mungesën e mjeteve materiale të qeverisë shqiptare për të vepruar në këtë mënyrë, Komisioni miratoi edhe pikat që vijojnë: të nisej një aksion politik ndaj aleates (Italisë-H.B.) që të informonte, nëse vërtetë ekzistonte një marrëveshje për shpërnguljen e kosovarëve në Turqi; në rast se vërtetohet ekzistenca e kësaj marrëveshjeje, duhej pyetur qeveria italiane se me ç'mënyrë mund të ndihmonte, qoftë pranë qeverisë jugosllave, me rastin e marrëveshjes italo-jugosllave që mendohej të nënshkruhej së shpejti, qoftë me anë të Lidhjes së Kombeve, apo me ndonjë mjet tjetër; kur të jepte përgjigje qeveria italiane, me mjetet diplomatike që disponoheshin pranë Lidhjes së Kombeve, në Beograd dhe pranë legatës jugosllave në Tiranë, duhej ndërmarrë një fushatë diplomatike për të penguar shpërnguljen e kosovarëve në Turqi.

III-Nëse plani i mësipërm dështonte, mendohej të hyhej në bisedime me qeverinë e Beogradit mbi konditat e krijimit të një zone në tokën jugosllave, përgjatë kufirit tonë, për t'iu dhënë kësaj toke të drejtat minoritare analoge me ato që qeveria jugosllave i kishte njohur minoritetit gjerman të Banatit jugosllav, duke pranuar njëkohësisht zbrazjen e elementit shqiptar nga tokat që ishin jashtë kësaj zone dhe për ta instaluar në këtë zonë ose në Shqipëri. Zona në fjalë duhej pranuar si minimum i koncensionit që mund të bënte shteti shqiptar.

IV-Në rast se edhe krijimi i kësaj zone nuk do të ishte i mundshëm, atëherë mjerisht do të duhej të lidhej marrëveshje me qeverinë jugosllave për të tërhequr atë sasi emigrantësh kosovarë që do të ishte e mundur kundrejt një dëmshpërblimi.

Në fund të këtij plani, ishin bërë disa shënime sipas të cilave, në rastet e pikave III, IV duhej të bisedohej edhe çështja e pasurive shqiptare në Jugosllavi, e cila kapte vlerën 400.000.000 dinarë, si dhe pagesa e shpenzimeve për shpërnguljen dhe instalimin e kosovarëve në Shqipëri. Në Organizatën Nacionaliste të Kosovës duhet të hynin personalitete të tilla si: Ferhat Draga, Hasan Shyqyri etj. Kësaj organizate do t'i jepeshin 300 napolona në vit dhe Vejsel Kryeziut duhej t'i jepej një shpërblim mujor. Dhurata periodike duhej t'u jepej dhe hoxhallarëve kosovarë. Për këta të fundit, legata shqiptare në Beograd duhej të dispononte 150 fr.ari në muaj. Nga rinia intelektuale kosovare duheshin përkrahur me bursa nga 60 fr.ari secili, 13 veta, që më parë mbaheshin me bursa nga Komuniteti Mysliman i Jugosllavisë. Kjo sepse, ky i fundit, duke qenë në dorë të boshnjakëve, s'mund të toleronte që intelektualët shqiptarë të dilnin nga shkollat e larta me diplomë. Selahudin Ferhat Dragës t'i jepej një bursë 140 fr.ari në muaj, Momçillo Ivanoviçit e federalistëve të tjerë jugosllavë nga veprimtaria politike e të cilëve mund të vinte dobi, t'u dërgoheshin shuma parash në mënyrë periodike.⁵³

Në fillim të vitit 1938, gazeta "Cumhuriyet" ("Republika") botoi një lajm sipas të cilit qeveria jugosllave kishte bërë një demarsh pranë Ankarasë për instalimin në Turqi të 200.000 "turqve" që jetonin në tokat e saj.⁵⁴ Një lajm të ngjashëm me të botoi edhe agjencia italiane "Stefani", duke komentuar se së shpejti midis Turqisë dhe Jugosllavisë do të nënshkruhej edhe një marrëveshje.⁵⁵ Megjithëse qarqet politike jugosllave dhe turke e mohonin një fakt të tillë, diplomatët shqiptarë raportonin se kjo çështje do të bisedohej së shpejti në Stamboll me rastin

⁵³ *Arkivi Qendror i Shtetit* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 251, Viti (më tej: V)1937, Dosja (më tej: D)126, fl.6-11. Projekt-plan i komisionit të posaçëm të qeverisë shqiptare për mbrojtjen e shqiptarëve të Kosovës, 11.1.1937.

⁵⁴ "Yugoslavya`daki türkler", *Cumhuriyet*, Ankara, 25.1.1938, s.1.

⁵⁵ *AMPJ*, V.1938, D.107, fl.7. Letër e ministrit të Punëve të Jashtme Ekrem Libohova, për legatën shqiptare në Beograd, 29.1.1938.

e Konferencës Ballkanike, në të cilën do të merrnin pjesë ministrat e jashtëm të vendeve të Antantës.⁵⁶

Sipas Foreign Office, qarqe me përgjegjësi në Shqipëri dhe sidomos Ministria e Punëve të Jashtme ishte shumë e shqetësuar për përfundimin e një marrëveshjeje ndërmjet Turqisë dhe Jugosllavisë.⁵⁷ Si rezultat i ndërhyrjeve të diplomacisë shqiptare, Londra i ndiqte me vëmendje tratativat jugosllavo-turke. Prandaj ajo kërkoi të dhëna nga legata britanike në Ankara mbi numrin e kosovarëve që mund të transferoheshin në bazë të kësaj marrëveshjeje. Përgjigjja zyrtare e qeverisë së Ankarasë se në Turqi do të lejoheshin që të emigronin vetëm turq, sipas ambasadorit anglez nuk ishte shumë e besueshme, për shkak se nuk kishte asnjë mënyrë për të dalluar shqiptarët nga turqit.⁵⁸

Përfaqësuesi anglez në Durrës ishte kundër propozimit të palës jugosllave për transferimin e 50.000 kosovarëve në Shqipëri, sipas tij, kjo do të peshonte shumë në kapacitetin financiar, ekonomik dhe administrativ të qeverisë shqiptare dhe, nuk do ta zgjidhte problemin e qindra mijë shqiptarëve të Jugosllavisë.⁵⁹

Sermed Xhaxhuli iu ankua ambasadorit anglez në Beograd se 800.000 shqiptarë të Kosovës ishin nën terrorin e përditshëm të shtetit jugosllav, sipas tij, çështja e minoritetit shqiptar në Jugosllavi ishte problemi më serioz i Europës. Ai shtoi se, ai nuk e besonte që bisedimet jugosllavo-turke po përparonin, për shkak se turqit i kishin duart e zëna me sistemimin e myslimanëve të transferuar nga Dobruxa dhe se nuk do të ishin në gjendje të paktën edhe për një tre vite të tjera të merreshin me 100.000 kosovarët që jugosllavët dëshironin të dërgonin në Turqi. Këtij mendimi i përmbaheshin edhe diplomatët anglezë. Nga bisedat që ata kishin zhvilluar me funksionarët jugosllavë, kishin krijuar përshtypjen se, bisedimet turko-jugosllave po përparonin shumë avash.⁶⁰

Sipas marrëveshjes Stojadinoviç-Aras, bisedimet për shpërnguljen e popullsisë “turke” nga Jugosllavia filluan më 9 qershor 1938, nën

⁵⁶ AMPJ, V.1938, D.107, fl.30. Letër e përfaqësuesit të Shqipërisë në Beograd, Tahir Shtylla, për MPJ, 9.2.1938.

⁵⁷ FO 371/21112. Raport i Foreign Office për ambasadorin anglez në Beograd Chancery, 23.2.1937.

⁵⁸ FO 371/21112. Raport i ambasadorit anglez në Ankara James Morgan për FO, 13.3.1937.

⁵⁹ FO 371/21112. Raport i ambasadorit anglez në Durrës për FO, 1.4.1937.

⁶⁰ FO 371/21112. Raport i ambasadorit anglez në Beograd për FO, 12.4.1937.

drejtimin e delegatit turk Hasan Saka. Në bisedime merrnin pjesë Cevdet Atasgon (Xhevdet Atasgon), Drejtor i Përgjithshëm për vendosjen e të ardhurve në Ministrinë e Higjenes dhe Ndihmës Sociale, Milan A.Ristiq, shef i Seksionit Ballkanik në Ministrinë e Jashtme jugosllave, Voislav V.Magovçeviq inspektor në Ministrinë e Bujqësisë së Jugosllavisë, ministrat e Rumanisë dhe Greqisë në Turqi, Telemak dhe M.R.Rafael. Bisedimet u mbajtën me dyer të mbyllura.⁶¹ Ato kishin kryesisht karakter teknik dhe më 11 korrik 1938 u kurorëzuan me nënshkrimin e Konventës jugosllavo-turke, e cila kishte 21 nene dhe do të hynte në fuqi vetëm pas ratifikimit nga parlamentet e të dyja vendeve.⁶² Në preambulën e kësaj konvente parashikohej shpërngulja e popullsisë myslimane “turke” dhe cekej se kjo ishte “kërkesë” e kësaj popullate, gjë që nuk përkonte me të vërtetën. Madje, ky konstatim nuk vlente as për popullsinë turke, e cila në numër fare të vogël jetonte nëpër qytete.⁶³ Sipas statistikave zyrtare jugosllave, popullsia turke në vitin 1921 ishte 150.322 banorë ose 1.26%, ndërsa në vitin 1931 kjo popullsi kishte pësuar një rënie të vogël në gjithsej 132.924 banorë ose 0.95 %.⁶⁴ Pjesët e kësaj marrëveshjeje u redaktuan në mënyrë që, siç del nga burime të ndryshme, të mundësohej edhe shpërngulja e shqiptarëve, që ishte “qëllimi i vërtetë i kësaj Konvente”.⁶⁵ Prof.Branko Horvat në librin e tij “Kosovsko pitanje” (“Çështja e Kosovës”) konstaton me të drejtë se sikur të realizohej kjo

⁶¹ Këto bisedime janë botuar nga studiuesi Hakif Bajrami. *Shih*: H. Bajrami, “Rreth përgatitjes së Konventës Jugosllavo-Turke...”, 223-237; Hakif Bajrami, *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi (dokumente)*, Prishtinë: 1996.

⁶² *AMPJ*, V.1938, D.107, fl.135-138. Relacion i legatës shqiptare në Beograd, për Ministrinë e Punëve të Jashtme; Ahmet Özgiray, “Türkiye-Yugoslavya İlişkileri (1920-1938)”, *Tarih İncelemeleri Dergisi*, Sayı 4, Izmir: Ege Üniversitesi Edebyat Fakültesi Yayını, 1999, s.22; H. Bajrami, “Konventa Jugosllavo-Turke...”, art. i cit., f.249-250.

⁶³ Emine Arifi Bakalli, “Konventa Jugosllavo-Turke e vitit 1938”, në *Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje*: (me vështrim të veçantë mbi burimet serbe të fakteve): Simpozium i mbajtur në Prishtinë më 20-21 janar 1994, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve, 1995, f.161.

⁶⁴ M.Kemal Özergin, “Yugoslavya`da Yaşayan Türkler”, *Türk Kültürü*, Sayı 11 (Eylül 1963), s.16.

⁶⁵ E. Bakalli, “Konventa Jugosllavo-Turke...”, f.161.

konventë, Beogradi do t'ia arrinte qëllimit të tij final, që ishte spastrimi etnik i trojeve shqiptare.⁶⁶

Për të parandaluar këtë katastrofë kombëtare Mbreti Zog rifilloi një fushatë aktive diplomatike. Ai ngarkoi një personalitet të njohur si Mirash Ivanaj për të zhvilluar takime me ambasadorët e Francës dhe Anglisë dhe për t'i kërkuar atyre t'u sugjeronin qeverive të veta që të përdornin të gjithë influencën e duhur për të ndaluar largimin e kosovarëve drejt Turqisë. Një shqetësim të njëjtë lidhur me Konventën jugosllavo-turke, i paraqiti ambasadorit anglez edhe ministri i Jashtëm Ekrem Libohova. Ai kërkoi që qeveria britanike të ndërhynte pranë Ankarasë për ta kundërshtuar transferimin e kaq shumë shqiptarëve në Turqi. Sipas tij, shumë njerëz nëpër qytetet dhe fshatrat e Kosovës, bashkë me shqipen flisnin edhe turqishten, bile, në disa zona predominante turqishtja, por kjo s'do të thoshte se ata ishin turq. Situata në të cilën ndodhej popullsia kosovare, vuajtjet dhe vështirësitë, ishin aq të mëdha sa që disa prej tyre ishin të gatshëm të shkonin në Turqi. Fakti se ata do të shkonin në një vend mysliman ishte iluziv, sepse udhëheqësit fetarë të Rumanisë dhe Jugosllavisë ishin duke e kundërshtuar emigrimin e myslimanëve drejt Turqisë, për shkak të qëndrimit të këtij vendi ndaj fesë.

Sipas konkluzioneve të ambasadorit anglez Sir A.Ryan qeveria shqiptare, tani ishte midis kudhrës dhe çekanit. Ajo nuk mund të strehonte në tokat e saj një numër kaq të madh kosovarësh. Megjithatë ajo nuk dëshironte të shihte bashkatdhetarët e saj të zhdukeshin drejt Turqisë. Ajo dëshironte më shumë se çdo gjë tjetër të shihte një bllok të ngurtë dhe të fortë shqiptarësh të përqendruar në Kosovë, në pritje kur ideali kombëtar për një Shqipëri të madhe do të mund të shndërrohej në realitet.⁶⁷

Për të parandaluar zbatimin e kësaj konvente gjatë vitit 1938, Ministria e Jashtëm bëri përpjekje që marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të kushtëzoheshin në varësi të respektimit të të drejtave të minoritetit shqiptar brenda territorit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.⁶⁸ Në një

⁶⁶ Hivzi Islami, *Kosova dhe shqiptarët* (Çështje demografike), Prishtinë: Pena, 1990, f.69.

⁶⁷ FO 371/22305. Raport i ambasadorit anglez në Durrës Sir A.Ryan për Viskont Halifax, 6.10.1938.

⁶⁸ Hasan Bello, "Politika e shtetit shqiptar ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës (vitet 20-30 të shek.XX)", *Perla*, Tiranë, nr.2, 2011, f.12-22.

promemorie që kjo Ministri i dërgoi legatës shqiptare në Beograd, e udhëzoi këtë të fundit se në çdo rast, Jugosllavisë i duhej imponuar që të merrte parasysh: mosdëbimin e shqiptarëve në Turqi, duke kërkuar që një shqiptar i Turqisë ose përfaqësues i minoritetit shqiptar të Jugosllavisë, të merrte pjesë në komisionin mikst turko-jugosllav, për të dalluar shqiptarët nga turqit që dëshironin të largoheshin në bazë të marrëveshjes midis dy shteteve të mësipërme; shqiptarëve të Kosovës të mos u merreshin tokat, që kështu të bëhej e mundur jetesa e tyre në Jugosllavi; qeveria jugosllave duhej të tregohej më tolerante me shqiptarët dhe të drejtat e tyre për t'u arsimuar në gjuhën amtare.⁶⁹ Në qoftë se Stojadinoviç pranonte kërkesat e mësipërme dhe zotohej se do t'i zbatonte ato, atëherë qeveria shqiptare ishte e gatshme të nënshkruante me shtetin fqinj një pakt miqësie ose mosagresioni, si dhe të merrte angazhime serioze, doemos në bazë reciprociteti, për të mos toleruar në territorin e saj asnjë veprimtari që ishte kundër Jugosllavisë.

Një rëndësi të veçantë shteti shqiptar i jepte dhe bashkëpunimit midis elementit shqiptar dhe atij boshnjak. Sipas promemories së mësipërme, duke përdorur ndjenjën fetare e cila tek të dyja palët ishte tepër e fortë, të krijohej një bllok i cili merrte një peshë të rëndësishme në balancën e politikës së brendshme jugosllave. Prandaj, influenza politike e liderit boshnjak Mehmet Spaho mbi shqiptarët e Kosovës shihej me nota pozitive. Nga ana tjetër, ky ishte dhe vëllai i Reisylylema-së, Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Jugosllavisë, pra kishte një interes të veçantë që të ndalej emigracioni i shqiptarëve myslimanë drejt Turqisë. Ministria e Jashtme urdhëroi përfaqësuesin shqiptar në Beograd që të hynte në kontakt me Mehmet Spahon dhe të bënte një sondazh për të mësuar opinionin që ai kishte lidhur me dekorimin që Mbreti Zog mendonte t'i bënte së shpejti.⁷⁰ Në promemorie vihej theksi dhe tek bashkëpunimi me opozitën kroate dhe për t'i bërë asaj të ditur të gjitha padrejtësitë që po i bëheshin shqiptarëve të Kosovës. Po aq i rëndësishëm ishte dhe uniteti midis personaliteteve kosovare. Atyre, sipas dokumentacionit, u duhej treguar se interesimi i shtetit shqiptar dhe Mbretit Zog për të parandaluar shpërnguljen dhe dëbimin e tyre në Turqi ishte maksimal. Menjëherë ata duhej t'i viheshin punës duke vizituar çdo katund dhe për të

⁶⁹ AQSH, F.251, V.1938, D.107/2, fl.763. Promemorie e Ministrisë së Jashtme, për legatën dhe konsullatat shqiptare në Jugosllavi, 20.3.1939.

⁷⁰ Po aty, fl.764.

ndërgjegjësuar popullin shqiptar që në asnjë mënyrë të mos pranonte të emigronte drejt Anadollit. Në promemorje parashikohej gjithashtu të nisej dhe një fushatë diplomatiko-mediatike, me qëllim për t'i bërë të njohur Lidhjes së Kombeve, shteteve europiane dhe opinionit publik botëror se ç'po ndodhte realisht me shqiptarët në Jugosllavi.

Me urdhër të Mbretit Zog, Ferhat bej Dragës, iu dhanë 4000 fr.ari për të shkuar në Turqi e për të takuar Ataturkun, me qëllim për të lobuar për mosratifikimin e Konventës jugosllavo-turke.⁷¹

Megjithë situatën tejmasë të rënduar si rezultat i presioneve të ushtruara nga Italia fashiste, shteti shqiptar nuk e uli aspak shkallën e interesit që kishte ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës. Në promemorian e hartuar nga Ministria e Jashtme më 20 mars 1939, legata shqiptare e Beogradit urdhërohej që të përpiqej për të krijuar marrëdhënie miqësore me qeverinë e re të Svetkoviç-it. Ajo duhej t'i bënte të ditur qeverisë jugosllave se nuk kishte asnjë çështje që mund t'i ndante të dy shtetet, veç asaj që lidhej me popullsinë shqiptare të Kosovës. Legata shqiptare udhëzohej që të shfrytëzonte dobësinë e qeverisë së re të Svetkoviç-it si dhe fuqinë e Mehmet Spahos për rregullimin definitiv të dy pikave kryesore të politikës minoritare të shtetit jugosllav: a) ndalimi i grabitjes së tokave dhe b) ndalimin e emigrimit të popullsisë shqiptare drejt Turqisë.

Në dobi të interesave shqiptare duheshin shfrytëzuar edhe rrethanat ndërkombëtare që ishin krijuar në vendet e Europës Qendrore. Duheshin studiuar edhe tendencat e politikës së Beogradit. Kështu, nëse ai i trembej ekspansionit gjerman, atëherë duhej përfituar nga turbullirat e brendshme. Qëndrimi i Jugosllavisë në situatën e krijuar, në prag të shpërthimit të luftës, kishte rëndësi të dorës së parë për Shqipërinë. Sipas urdhrit të Mbretit Zog, duhej të krijohej një komitet nën kryesinë e Ferhat bej Dragës për politikën minoritare, veprimtaria e të cilit do të ishte nën kontrollin e legatës shqiptare të Beogradit. Ky komitet do të përbëhej më së paku nga tre anëtarë, të cilët mund të ishin deputetët shqiptarë në Parlamentin Jugosllav Salih Kadri, Iliaz Prishtina, Muhamet Sllatkoja ose Xhevat Begolli. Me pëlqimin e Mbretit, ndonjë nga këta persona mund të zëvendësohej me dikë tjetër. Për këtë, shihej e domosdoshme ardhja e Ferhat bej Dragës në Shqipëri, sepse, vetëm kështu Mbreti Zog, do të

⁷¹ *Po aty*, fl.765-766.

kishte mundësi t'i jepte udhëzime konfidenciale për të mos dekonspiruar planin dhe rrjetin e bashkëpunëtorëve.⁷²

Si fillim të aktivitetit të tij, ky komitet do të kishte zbatimin e pikave të mëposhtme: a) të themelonte një organ periodik në gjuhën sllave, turke dhe më vonë edhe një faqe në gjuhën shqipe, që të mbronte të drejtat e myslimanëve të Kosovës b) të hapte shtatë konvikte në shtatë prefekturat e Kosovës ku ndodhej vetëm një gjimnaz shteti. Në to do të qëndronin bijtë e bajraktarëve dhe agallarëve të Kosovës për të marrë arsimin bazë, e më pas për t'u dërguar në universitetet e Jugosllavisë. Këto konvikte zyrtarisht do të financoheshin gjoja nga subvencionet e organizatës "Merhameti". Konviktet duheshin furnizuar me literaturë shqipe, për t'i edukuar këta të rinj me frymën e atdhedashurisë dhe në gjuhën amtare c) të hartonte një listë të klerikëve myslimanë dhe katolikë shqiptarë të cilët do t'i ndihmonte dhe t'i shfrytëzonte për aktivitetin e tij në qendrat respektive d) të hartonte një listë me tituj librash në gjuhën shqipe që nevojiteshin për mësimin e gjuhës amtare nga brezi i ri kosovar e) të kujdesej për shpërndarjen e revolverëve dhe orave me stemën e Mbretit Zog, të cilat, ai do t'ia dhuronte parisë së Kosovës f) të kujdesej për shpërndarjen e disa radiove me anën e tregtarëve, pasi do të instaloheshin dy stacione transmetimi, njëri në Shkup dhe tjetri në Beograd g) të gjente edhe disa studentë të tjerë kosovarë që numri i tyre të shkonte të paktën në 50 vetë.⁷³

Tabela 1: Numri i shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova dhe trojet e tjera shqiptare drejt Turqisë përgjatë viteve 1919-1939⁷⁴

Viti	Numri i personave të shpërngulur
1919	23.500
1920	8.536
1921	24.532

⁷² *Po aty.*, fl.797; Ferhat bej Draga ishte në lidhje të vazhdueshme me qeverinë e Tiranës, nga e cila pranonte edhe ndihma financiare. *Shih*: Halim Purellku, "Veprimtaria e Komitetit të Kosovës në Mbretërinë Shqiptare në vitet 1934-1939", *Studime-Historike*, nr.3-4, Tiranë: 2009, f.235.

⁷³ *Po aty*; *Shih*: Fatmira Rama, "Komiteti i Kosovës në bashkëpunim me organizatat e tjera politike (1925-1939)", në vëll. *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 2004, f.129-150.

⁷⁴ H. Bajrami, "Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi...", f.146.

1922	12.307
1923	6.389
1924	9.630
1925	4.315
1926	4.012
1927	5.197
1928	4.326
1929	6.219
1930	13.215
1931	29.807
1932	6.219
1933	3.420
1934	14.500
1935	9.567
1936	4.252
1937	4.234
1938	7.251
1939	7.255
Gjithsej	208.683

Si përfundim, Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 nuk u ratifikua nga Turqia. Për këtë ndikuan disa faktorë nga ku më kryesorët ishin:

a) Qëndrimi i shtetit shqiptar,⁷⁵ qeveria e të cilit, siç u pa dhe më sipër, ndoqi një politikë aktive duke organizuar një farë qendrese në terren si dhe duke lobuar me anë të diplomacisë dhe individëve të caktuar në qarqet proshqiptare të politikës turke. Si rezultat i kësaj politike “në kohën kur autoritetet e Beogradit bënin plane të fshehta për dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta, respektivisht, numri i familjeve që u shpërngulën gjatë viteve 1938-1941 ra në minimum”.⁷⁶ Një fakt të tillë e konfirmon edhe historiografia turke, sipas së cilës, përgjatë viteve 1923-1933 nga Jugosllavia drejt Turqisë u shpërngulën

⁷⁵ Këtë meritë të shtetit shqiptar dhe sidomos të Mbretit Zog kundër shpërnguljes eventuale të shqiptarëve nga Kosova e kanë pohuar edhe përfaqësues të historiografisë jugosllave dhe shqiptare. *Shih:* V.Vinaver, “Çështja shqiptare...”, f.93; Marenglen Verli, “Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20-30 të shek.XX”, në *Monarkia shqiptare 1928-1939*, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2011, f.255.

⁷⁶ Qerim Lita, “Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi (1937-1941)”, në *Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar*, Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2013, f.213.

108.179 veta. Ndërsa pas këtij viti ky fenomen u ngadalësua. Kështu në vitet 1934-1939, periudhë e cila përkon me shtimin e vëmendjes së shtetit shqiptar ndaj parandalimit të emigrimit të popullsisë kosovare nga trojet e saj, sipas një studiuesi, drejt Turqisë u shpërngulën vetëm 7.248 veta.⁷⁷

b) Faktor i dytë frenues ishte qëndrimi i politikës italiane. Shqiptarët në sytë e saj shiheshin si element me rëndësi në fazën e parë të realizimit të synimeve të saj ndaj Ballkanit. Kosova mund të përdorej (siç edhe u përdor pas 7 prillit 1939-H.B.) me sukses për efekte demagogjike, duke iu premtuar shqiptarëve bashkimin kombëtar.⁷⁸ Sipas raporteve të legatës italiane në Tiranë, për një numër shqiptarësh nga të dy anët e kufirit, bashkimi kombëtar paraqitej si më i rëndësishëm se sa vetë sovraniteti i Shqipërisë.⁷⁹ Prandaj, pavarësisht rrjedhove negative që pati pushtimi italian i Shqipërisë dhe më vonë i Kosovës, ai u bë pengesë faktike e zbatimit të Konventës jugosllavo-turke të vitit 1938.

c) Faktori më i rëndësishëm për mosratifikimin e Konventës jugosllavo-turke ishte vetë Turqia. Që kur u nënshkrua Konventa, ajo i deklaroi Jugosllavisë se ratifikimi i saj do të bëhej vetëm në janar të vitit 1939. Kjo hapësirë kohore do t'i shërbente Ankarasë për të vëzhguar trendet politike në Evropë dhe mundësinë e ndryshimeve të konstelacionit politik në Ballkan si rezultat i tyre.⁸⁰

Një ndikim të madh pati edhe vdekja e Atatürkut më 10 nëntor 1938, e cila krijoi një situatë ekuivoke dhe deri diku të pasigurtë për politikën e brendshme dhe të jashtme që do ndiqte më pas Turqia. Synim i saj tani e tutje do të bëhet qëndrimi me çdo kusht jashtë konfliktit botëror që po afronte.⁸¹

⁷⁷ Studiuesi turk Cevdet Geray i përmbahet konkluzionit se përgjatë viteve 1923-1939 nga Jugosllavia drejt Turqisë kanë emigruar 115.427 veta. *Shih: Cevdet Geray, Türkiye'den ve Türkiye'ye göçlerve göçmenlerin iskânı, 1923-1961*, Ankara: Siyasal Bilgiler Fakültesi Maliye Enstitüsü, 1962, s.80.

⁷⁸ E. Bakalli, "Konventa Jugosllavo-Turke", f.162.

⁷⁹ Jacomoni di san Savino, Francesco, *La politica italiana in Albania*, Bologna: Cappelli editore 1965, p.55.

⁸⁰ Mustafa Yılmaz, "Inönü Dönemi Türk Dış Politikası", *Selçuk Üniversitesi Atatürk İlkeleri ve İnkılap Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi*, Sayı: 8, Konya, 1999, s.17; Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga historia moderne dhe bashkohore shqiptare*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011, f.83.

⁸¹ Necdet Ekinci, *Inönü Dönemi ve II. Dünya Savaşı Yılları, Genel Türk Tarihi*, Ankara, Cilt: 9, 2002, s.646.

Nga të dhënat e deritanishme na rezulton se brenda politikës, administratës dhe ushtrisë turke, ekzistonte edhe një opozitë e fuqishme, e përbërë kryesisht nga elementë me origjinë shqiptare, që ishte kundër ratifikimit të kësaj Konvente.⁸² Kështu, zvarritja e ratifikimit të saj me arsyetimin se i mungonin mjetet financiare ishte më shumë një pretekst, sidomos në kohën kur Jugosllavia tregoi gadishmëri të plotë për të marrë përsipër shpenzimet e palës turke për shpërnguljen. Tratativat Beograd-Ankara u zbehën në verë të vitit 1939. Kjo përkon me njohjen *de facto* nga Evropa të pushtimit të Shqipërisë nga Italia dhe rreziqet që dilnin nga zbatimi i kësaj konvente.⁸³

S u m m a r y

THE POLICY OF ALBANIAN MONARCHY TO PREVENT THE KOSOVAR'S DISPLACEMENT TO TURKEY AND THE RATIFICATION OF THE YUGOSLAV-TURKISH CONVENTION OF 1938

Since 1913 a part of the Albanian regions and population were left within the state boundaries of Serbia and Montenegro. With regards to this issue, the Yugoslav authorities acted according a “well designed” program, which for a long time was systematically implemented, aiming at destroying the homogeneity of this compact population and eventually its physical elimination. Considering that their displacement to other parts of Yugoslavia did not result efficient, they took another approach, the displacement to Turkey. Faced with such an issue, the Albanian government held a firm position. It was in the national interest of Albania not to allow their emigration to Turkey but also not to allow their emigration to the interior of the Albanian Monarchy's territories either, as the financial situation of the Albanian state did not favor the emigration at such a large scale.

The Albanian government tried continuously to persuade Ankara to avoid the displacement of the Kosovar population from its lands. On the 19th of November 1932 Nezir Leskoviku met with the Turkish foreign minister Tefvik

⁸² V. Vinaver, “Çështja shqiptare...”, f.95.

⁸³ E. Bakalli, *Çështje nga historia...*, f.83.

Rüştü Aras and asked the latter that the Turkish consulates in Yugoslavia should stop issuing visas for the Kosovar population. Tefik Rüştü Aras assured Nezir Leskoviku that the Turkish government would not allow the Turkish consulates in Yugoslavia to issue visas for the Albanians and that it would deny the admission of any Kosovar emigrants in the country.

On 28 February 1933, Tefik Rüştü Aras, on the suggestion of Ataturk, visited Belgrade. He met with the Yugoslav authorities and started the negotiations with Begolub Jevtiq for the signing of a friendship and nonaggression pact between Turkey and Yugoslavia. In the framework of these talks the Yugoslav authorities discussed also the displacement of the Albanians to Anatolia. Immediately after this meeting, the Foreign Minister of Yugoslavia sent a secret telegram to the Yugoslav diplomatic representative in Istanbul in which ordered that every prominent Albanian should not be allowed to return to Kosovo.

The Albanian government was very worried by the collaboration between Turkey and Yugoslavia as this went against the Albanian national interests.

